



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2024:090380

Datë: 20.06.2024

Numri i dokumentit: 05943619

PS.nr.30/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE–DEPARTAMENTI SPECIAL NË PRISHTINË, Kryetare e trupit gjykues-gjyqtare Violeta Namani-Hajra, në çështjen penale kundër të pandehurit B.S ka kryer veprën penale Ushtrimi i ndikimit nga neni 424 par.2 i KPRK-së dhe veprën penale Mashtrim me subvencione nga neni 324 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së, e pandehura K.B-S ka kryer veprën penale Dhënie ryshfeti nga neni 422 par.2 të KPRK-së, të pandehurit A.U dhe V.H në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi kanë kryer veprën penale Marrje ryshfeti nga neni 421 par.1 lidhur me nenin 31 dhe nenin 77 të KPRK-së, i pandehuri G.A ka kryer veprën penale Ushtrim i ndikimit nga neni 424 par.2 të KPRK-së, i pandehuri F.Y ka kryer veprën penale Dhënie e ryshfetit nga neni 422 par.1 të KPRK-së, i pandehuri A.T ka kryer veprën penale Dhënie e ryshfetit nga neni 422 par.1 të KPRK-së, i pandehuri B.O ka kryer veprën penale Dhënie e ryshfetit nga neni 422 par.1 të KPRK-së, i pandehuri A.S ka kryer veprën penale Dhënie e ryshfetit nga neni 422 par.1 të KPRK-së, i pandehuri M.M ka kryer veprën penale Dhënie e ryshfetit nga neni 422 par.1 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, PPS.nr.52/2024 të datë 21.03.2024, në seancën fillestare të mbajtur me datë 08.05.2024, në praninë e Prokurorit Special, të pandehurve të lartcekur me mbrojtësin e tyre, në bazë të nenit 364 të KPP-së gjykata me datë **13.05.2024** publikisht shpalli, dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër të pandehurve:

1.B.S, i biri i ... dhe nënës ..., i gjinisë ..., i lindur me datë ..., me vendbanim, rrugën ..., në ..., i martuar, ka të kryer Fakultetin Ekonomik, ekonomist, me numër personal: ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë në masën e paraburgimit dhe arrestit shtëpiak nga data 03.12.2021 deri 03.05.2022.

2.K.B.S, e bija e ... dhe nënës ..., e gjinisë ..., e lindur me datë ..., me vendbanim në rrugën "...", në ..., e martuar, master në Ekonomi, Zyrtare e Arkivës në ..., e gjendjes së mesme financiare, me numër personal: ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë në masën e arrestit shtëpiak nga data 24.02.2021 deri 24.09.2021.

3.A.U, e bija e ... dhe nënës ..., e gjinisë ..., e lindur me datë ..., në fshatin ..., ku edhe jeton, e pa martuar, inxhinierë e bujqësisë, inspektore e ..., gjendja financiare e mesme, me numër personal: ..., shqiptarë, shtetasë e Republikës së Kosovës, ka qenë në masën e paraburgimit dhe arrestit shtëpiak nga data 24.02.2021 – 24.05.2021.

4.V.H, i biri i ... dhe nënës ..., i gjinisë ..., i lindur me datë ... në Fshatin – Komuna ..., ku edhe jeton, i pa martuar, inspektor në ..., gjendja e mesme financiare, me numër personal: ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë në masën e paraburgimit dhe arrestit shtëpiak nga data 30.06.2021 deri 30.03.2022.

5. G.A, i biri i ... dhe nënës ..., e gjinisë ..., i lindur me datë ..., në fshatin ..., ku edhe jeton, i pamartuar, ka të kryer Fakultetin e Bujqësisë – Agroekonomi, Zyrtar në ..., i gjendjes së mesme financiare, me numër personal: ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë në masën e paraburgimit dhe arrestit shtëpiak nga data 30.06.2021 deri 30.03.2022.

6. F.Y, i biri ... dhe nënës ..., e gjinisë ...i, i lindur me datë ..., me vendbanim në rrugën "...", në ..., i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, bujk, me numër personal: ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

7. A.T, i biri i ... dhe nënës ..., i gjinisë ..., i lindur me datë ... në fshatin ..., Komuna e ... ku edhe jeton, i martuar, bujk, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së mesme financiare, me numër personal: ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

8. B.O, i biri i ... dhe nënës ..., i gjinisë ..., i lindur me datë ..., i martuar, bujk, ka të kryer shkollën e mesme, gjendjes së mesme financiare, me numër personal: ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

9. A.S, i biri i ... dhe nënës e ..., i gjinisë ..., i lindur me datë ..., në Fshatin ... Komuna ..., ku edhe jeton, i martuar, fermer, ka të kryer shkollën e lartë të Pedagogjisë, i gjendjes së mesme financiare, me numër personal: ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

10. M.M, i biri i ... dhe nënës ..., e gjinisë ..., i lindur me datë ... në ..., ku edhe jeton në rrugën "...", i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal: ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

I. I pandehuri **B.S** konfom nenit 364 par 1 të KPP-së,

ËSHTË FAJTOR

I.

Me datë 20.01.2020, në Prishtinë dhe Fushë Kosovë, i pandehuri B.S në mënyrë të drejtpërdrejtë i ofron dhe i jep përfitim pasuror të pandehurit K.Z që në cilësinë e personit zyrtar, si Inspektor teknik në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë të ushtrijë ndikim mbi vendimmarrjen e personave zyrtar në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, në atë mënyrë që fillimisht B.S me

datë 02.04.2018 në emër të biznesit ”...” aplikon me projektin “Zgjerimi i Objektivit dhe Investimet në Pajisje për përpunim, paketim dhe ambalazhim”, dhe pasi shpallet fitues me datë 22.10.2018 nënshkruan kontratën nr.... me Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, mirëpo në bazë të kontrollit nga komisioni në teren me datë 16.11.2019, merret Vendim për refuzim Ref:AZHB.07/4/1265/2019, datë 05.12.2019, pasi që aplikuesi nuk i plotëson kushtet sipas Udhëzimit administrativ nr.05/2018, sepse inspektorët konstatojnë se B.S ka mashtruar duke paraqitur makineri të përdorura kinse të reja, pastaj K.Z e udhëzon B.S që të praqes ankesë me premtimin se do të ushtrojë ndikim të zyrtarët e AZHB-së dhe për këtë kërkon shumën 20,000.00€ dhe B.S vazhdon procedurën e ankimimit pastaj me datë 20.01.2020 takohet me K.Z në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë dhe kur njoftohet me Vendimin për rivlerësim të datës 20.01.2020 i jep K.Z shumën 10,000.00€, pastaj sipas marrëveshjes paraprake pas disa ditësh B.S prapë takohet me K.Z në parking e ETC-së në Fushë Kosovë dhe i jep pjesën e dytë prej 10,000.00€, duke i dhënë gjithsej shumën e përgjithshme të rryshfetit prej 20,000.00€.

- **Me këtë ka kryer veprën penale Ushtrim i Ndikimit nga neni 424 paragrafi 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.**

II.

Në periudhën nga 12.04.2018 deri me 21.05.2020, i pandehuri B.S me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore në mënyrë të kundërligjshme ka bërë mashtrim me subvencione duke paraqitur të dhëna të pa sakta në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, në atë mënyrë që me datë 12.04.2018 në emër të biznesit ”...” SH.P.K, aplikon me projektin “Zgjerimi i Objektivit dhe Investimet në Pajisje për përpunim, paketim dhe ambalazhim” dhe pasi shpallet fitues me datë 22.10.2018 nënshkruan kontratën nr.560/2018 me bashkëfinancim nga 50%, në vlerë të përgjithshme 399,600.00€, mirëpo gjatë realizimit të projektit në bazë të kontrollit nga komisioni në teren me datë 16.11.2019, merret Vendim për refuzim Ref:AZHB.07/4/1265/2019, datë 05.12.2019, pasi që aplikuesi nuk i plotëson kushtet sipas Udhëzimit administrativ nr.05/2018, sepse inspektorët konstatojnë se i pandehuri B.S ka mashtruar duke paraqitur makineri të përdorura kinse të reja, po ashtu i pandehuri B.S gjatë aplikimit paraqet dokumentacion fiktiv me qëllim të arritjes së pikëve më të larta gjatë poentimit dhe mbi bazën e këtyre deklarimeve të rreme kishte përfituar grantin në mënyrë të kundërligjshme në bazë të Vendimit 07/4/2-002729/2020, datë 19.10.2020, në vlerë 199,800.00€.

- **Me këtë ka kryer veprën penale Mashtrim me Subvencione nga neni 324 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës**

Andaj gjykata me aplikimin e neneve 7,17, 38, 39,40, 42,43, 69,76, 79, 424 par 2, neni 324 par 3 lidhur par 1 të KPRK-së dhe nenit 364, 449, 450 dhe 452 të KPPRK-së, të pandehurin e :

G J Y K O N

Të pandehurin B.S për veprën penale Ushtrimi i ndikimit nga neni 424 par.2 i KPRK-së, i shqiptohet dënim me burg prej 3 muaj dhe dënim me gjobë në shumë prej 5000.00 €.

Të pandehurin B.S për veprën penale Mashtrim me subvencione nga neni 324 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së, i shqiptohet dënim me burg prej 3 muaj, dhe dënim me gjobë në shumë prej 15,0000.00 €.

Në bazë të nenit 76 par.1. të KPRK-së, të pandehurit i shqipton:

DENIM UNIK

Dënim me burg prej 5 muaj, në të cilin dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në masën e paraburgimit dhe masën e arrestit shtëpiak nga data 03.12.2021 deri me datë 03.05.2022, dhe dënim me gjobë në shumë prej 20,0000.00 €.

Nëse dënimin me gjobë i pandehuri B.S nuk dëshirojnë ta paguajnë ose nuk mundën ta paguajnë gjykata bazuar në nenin 43 par 3 të KPRK-së, dënimin me gjobë mund t ia zëvendësojë në dënim me burgim.

I pandehurin B.S në mënyrë vullnetare ka bërë kompenzimin e dëmit të shkaktuar në vlerë prej 184,857.53 euro.

Obligohet i pandehuri i lartcekur që ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës, në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej njëqind **(100) €**, ndërsa shumën prej njëqind **(100) €**, për Fondin për Kompensimin të Viktimave të Krimit, të gjitha ti paguaj në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II. E pandehura K.B.S, konform nenit 364 par 1 të KPPRK-së,

ËSHTË FAJTOR

Me datë 18.02.2021 dhe 22.02.2021, në Prishtinë, në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, e pandehura K.B.S i jep ryshfet të pandehurve L.S Drejtor për Pagesa Direkte dhe S.Sh Zyrtar për pagesa direkte në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë që të veprojnë në kundërshtim me detyrën zyrtare, në atë mënyrë që fillimisht i pandehuri A.N në bazë të aplikimit nr.35/133798, datë 29.07.2020, ka deklaruar rrejshëm se ka 80 shoqëri bletësh, ndërsa me rastin e kontrollit me datë 27.11.2020 Inspektoret në Procesverbal konstatojnë se posedon vetëm 25 shoqëri bletë, dhe mbi bazën e kësaj merret Vendim Ref:AZHB.07/4/2-029020/2020, datë 02.12.2020 për përjashtim nga Programi për shkak të mashtrimit, mirëpo pas një kohe e pandehura A.Gj përmes emaili të datës 08.12.2020, pa paraqitur fare kërkesë A.N i lëshon në mënyrë të kundërligjshme dokument të falsifikuar me titull “Deklaratë” kinse e ka nxjerrë një muaj më herët me datë 08.11.2020, të pa protokolluar, të pa vulosur dhe të panëshkruar nga Drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë dhe A.N në bazë të këtij dokumenti paraqet ankesë me datë 08.12.2020 në AZHB, pastaj me datë 18.02.2021 derisa ishin duke u aplikuar masat e veçanta hetimore në zyrat e AZHB-së K.B takohet në zyrën e drejtorit L.S dhe S.Sh dhe fillimisht i kërkohen 2,000 € për ta hequr nga lista e zezë lenden e A.N, mirëpo pas negociimit në fund vendos i pandehuri L.S që

shuma e ryshfetit të jetë 1,000 €, pastaj me datë 22.02.2021, ora 14:10 K.B në korridorin e AZHB-së i dorëzon ryshfet S.Sh në vlerë 1,000 € dhe ky i fundit pasi pranon parat sipas marrëveshje paraprake në ora 15:40, i dorëzon të pandehurit L.S shumën prej 500 €.

- ***Me këtë ka kryer veprën penale Dhënie Ryshfetit nga neni 422 paragrafi 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës***

Andaj gjykata me aplikimin e neneve 7,17, 38, 39,40, 42,43, 69, 79, 422 par 2 të KPRK-së dhe nenit 364, 449, 450 dhe 452 të KPPRK-së, të pandehurën e :

G J Y K O N

Të pandehurën K.B.S, i shqiptohet dënim me burg prej 5 muaj dhe dënim me gjobë në shumë prej 500€, në të cilin vendim llogaritet edhe koha e kaluar në masën e arrestit shtëpiak prej datës nga data 24.02.2021 deri me datë 24.09.2021, i cili dënim nuk do të ekzekutohet deri sa aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Nëse dënimin me gjobë e pandehura K.B.S, nuk dëshirojnë ta paguajnë ose nuk mundën ta paguajnë gjykata bazuar në nenin 43 par 3 të KPRK-së, dënimin me gjobë mund t ia zëvendësojë në dënim me burgim.

Obligohet e pandehura e lartcekur që ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës, në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej njëqind **(100) €**, ndërsa shumën prej njëqind **(100) €**, për Fondin për Kompensimin të Viktimave të Krimit, të gjitha ti paguaj në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

- III.** Të pandehurit A.U, dhe V.H, konfom nenit 364 par 1 të KPPRK-së,

JANË FAJTOR

Pika 3.1

Gjatë muajit shkurt 2021, në Prishtinë dhe Ferizaj në bashkëkryerje e pandehura A.U dhe V.H në cilësi të personave zyrtar si Inspektor në teren pranojnë ryshfet nga e pandehura V.I me qëllim që t'i ndihmojnë përfitimin e subvencionit, në atë mënyrë që fillimisht V.I kishte aplikuar për përfitim të subvencioneve në bazë të aplikimit nr.30/153278, datë 26.08.2020 për kultura bujqësore dhe blegtori, e pandehura A.U dhe V.H paraprakisht ishin koordinuar dhe kishin kërkuar ryshfet nga V.I se do t'i ndihmojnë për marrjen e subvencioneve, pastaj V.I i jep ryshfet të pandehurës A.U fillimisht 2,000 €, pastaj A.U shumën prej 1,000 € i dorëzon L.S te “Viva Fresh” në Veternik, ndërsa 500 € i ndal për vete dhe 500 € i jep të pandehurin V.H, pastaj gjatë muajit shkurt 2021 në restorantin e HIB Petrol në Ferizaj e pandehura A.U pranon edhe 100 € ryshfet nga e pandehura V.I,-

Pika 3.2

Me datë 05.11.2020, në fshatin Stanqiq, komuna Gjilan, i pandehuri V.H dhe A.U në cilësi të personit zyrtarë, si Inspektor në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë pranojnë ryshfet nga i pandehuri A.T me qëllim që t'i ndihmojnë në përfitimin e subvencionit, në atë mënyrë që fillimisht A.T kishte aplikuar për përfitim të subvencioneve për blegtori në bazë të aplikimit nr.08/140789, datë 06.08.2020, të pandehurit A.U dhe V.H në cilësi të inspektorëve kishin shkuar për kontroll në teren dhe fillimisht kishin paraqitur disa vërejtje rreth aplikimit, pastaj kërkojnë para ryshfet për të mos ta hartuar raportin negativ dhe pasi i pandehuri A.T iu jep para ryshfet A.U dhe V.H secilit nga 100 €, atëherë hartojnë Raportin nr.006814, datë 05.11.2020,-

Pika 3.3

Me datë 16.11.2020, në Pozhoran, komuna Viti, i pandehuri V.H dhe A.U në cilësi të personit zyrtarë, si Inspektor në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë në bashkëkryerje pranojnë ryshfet nga B.O me qëllim që t'i ndihmojnë në përfitimin e subvencionit, në atë mënyrë që fillimisht i pandehuri B.O kishte aplikuar për përfitim të subvencioneve në bazë të aplikimit nr.30/152111, datë 24.08.2020, e pandehura A.U dhe V.H në cilësi të inspektorëve me datë 16.11.2020 kishin shkuar për kontroll në teren dhe fillimisht kishin paraqitur disa vërejtje rreth aplikimit, pastaj kërkojnë ryshfet për të mos ta hartuar raportin negativ dhe i pandehuri B.O iu jep ryshfet të pandehurve A.U dhe V.H secilit nga 100 €, në oborrin e shtëpisë së tij, pastaj të pandehurit hartojnë Raportin nr.002488 datë 16.11.2020,-

Pika 3.4

Me datë 18.11.2020, në Radivojcë, Komuna Viti, i pandehuri V.H dhe A.U në cilësi të personit zyrtarë, si Inspektor në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë në bashkëkryerje pranojnë ryshfet nga F.J me qëllim që t'i ndihmojnë në përfitimin e subvencionit, në atë mënyrë që fillimisht i pandehuri F.J kishte aplikuar për përfitim të subvencioneve për dele, në bazë të aplikimit nr.30/144490, datë 11.08.2020, të pandehurit A.U dhe V.H në cilësi të inspektorëve kishin shkuar për kontroll në teren dhe fillimisht kishin paraqitur disa vërejtje, pastaj së bashku shkojnë në një kafiteri në hyrje të fshatit Begrac dhe në këtë takim kërkojnë nga F.J ryshfet 1,200 €, mirëpo i pandehuri F.J iu jep në këtë takim vetëm 200 €, ndërsa herën tjetër i pandehuri F.J ishte takuar me të pandehurën A.U afër marketit "Mediteran" në hyrje të Vitisë dhe i jep ryshfet shumë prej 1,000 €,-

Pika 3.5

Gjatë muajit nëntor të vitit 2020, në fshatin Begrac, komuna Viti, i pandehuri V.H dhe A.U në cilësi të personit zyrtarë Inspektor në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë në bashkëkryerje pranojnë ryshfet nga i pandehuri G.A me qëllim që t'i ndihmojnë përfitimin e subvencionit, në atë mënyrë që fillimisht fermerja E.A kishte aplikuar për përfitim të subvencioneve për vitin 2020, të pandehurit A.U dhe V.H në cilësi të inspektorëve kishin shkuar për kontroll në teren në fshatin Begrac duke gjetur disa parregullsi, por nuk kishin takuar fermerin, mirëpo më vonë kontaktohen nga i pandehuri G.A dhe për të mos ta hartuar raportin negativ A.U dhe V.H i kërkojnë ryshfet, pastaj i pandehuri G.A pas disa ditësh i jep ryshfet shumë 450 € të pandehurës A.U,-

Pika 3.6

Gjatë muajit nëntor 2020, në Gjilan, e pandehura A.U dhe B.P në cilësi të personave zyrtar, si Inspektor në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë në bashkëkryerje pranojnë ryshfet nga i pandehuri F.Y me qëllim që t'i ndihmojnë në përfitimin e subvencionit, në atë mënyrë që fillimisht F.Y kishte aplikuar për përfitim të subvencioneve për krerë të lopëve në bazë të aplikimit nr.0/134364, datë 30.07.2020, të pandehurit A.U dhe B.P në cilësi të inspektorëve kishin shkuar për kontroll në teren dhe fillimisht kishin paraqitur disa vërejtjeje sepse disa nga krerët e lopëve nuk kishin pasur të vendosura matrikulat, pastaj kishin kërkuar ryshfet në vlerë prej 2,000 € për të mos ta hartuar raportin negativ dhe për këtë ishte pajtuar i pandehuri F.Y dhe sipas marrëveshjes paraprake me të pandehurit A.U dhe B.P pas disa ditësh i pandehuri F.Y shkon në zyrën e Regjionale të AZHB-së në Gjilan dhe i dorëzon ryshfet të pandehurës A.U në vlerë prej 1,600 €.

Pika 3.7

Gjatë muajit nëntor të vitit 2020, në fshatin Cërnice, komuna Gjilan, e pandehura A.U dhe B.P në cilësi të personave zyrtar, si Inspektor në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë në bashkëkryerje pranojnë ryshfet nga M.M me qëllim që t'i ndihmojnë në përfitimin e subvencionit, në atë mënyrë që fillimisht M.M kishte aplikuar në emër të djalit të tij F.M "...” për përfitim të subvencioneve, i pandehuri B.P dhe A.U në cilësi të inspektorëve kishin shkuar për kontroll dhe fillimisht kishin paraqitur disa vërejtjeje, pastaj kishin kërkuar ryshfet për të mos ta hartuar raportin negativ dhe për këtë ishte pajtuar i pandehuri M.M duke iu dhënë A.U dhe B.P secilit nga 100 € në oborrin e fermës së tij, pastaj në rastin tjetër derisa i pandehuri M.M kishte aplikuar për përfitimin e garantit në emër familjares N.M në emër të firmës "...” të nesërmen ishte kontaktuar nga A.U ku i kishte kërkuar ryshfet shumën 1,000 €, mirëpo i pandehuri M.M i jep ryshfet vetëm shumën 500 € te market "...” në Gjilan.

Pika 3.8

Gjatë muajit nëntor të vitit 2020, në fshatin Uglar, komuna Gjilan, e pandehura A.U dhe B.P në cilësi të personave zyrtar, si Inspektor në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë në bashkëkryerje pranojnë ryshfet nga i pandehuri A.S me qëllim që t'i ndihmojnë në përfitimin e subvencionit, në atë mënyrë që fillimisht i pandehuri A.S kishte aplikuar për përfitim të subvencioneve në bazë të aplikimit nr.08/148753, datë 17.08.2020, të pandehurit A.U dhe B.P në cilësi të inspektorëve me datë 28.10.2020 kishin shkuar për kontroll në teren dhe fillimisht kishin paraqitur disa vërejtje, pastaj pas kontrollit takohen me A.S në parkingun e Restorantit "...” në hyrje të Gjilanit dhe gjatë bisedës i kërkojnë A.S ryshfet në vlerë 2,000 € për të mos ta hartuar raportin negativ, atëherë në fund pajtohen për vlerën e ryshfetit 1,200 € dhe të pandehurit A.U dhe B.P hartojnë Raportin nr.006810, datë 28.10.2020, pastaj pasi i pandehuri A.S pranon parat e subvencioneve, i dorëzon ryshfet A.U në vlerë prej 1,200 € në parkingun e Drejtorisë Regjionale për Bujqësi në Gjilan, ashtu siç ishte pajtuar paraprakisht edhe me B.P në parkingun e Restorantit "...”.

- ***Me këtë në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi kanë kryer veprën penale Marrje Ryshfeti nga neni 421 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 dhe nenin 77 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.***

Andaj gjykata me aplikimin e neneve 7,17, 38, 39,40, 42,43, 59, 62, 69,70, 79, 421 par 1 lidhur me nenin 31 dhe nenin 77 të KPRK-së dhe nenit 364, 449, 450 dhe 452 të KPPRK-së, të pandehurit i :

G J Y K O N

I.Të pandehurës A.U, i shqiptohet dënim me burg prej 2 vite dhe dënim me gjobë në shumë prej 5,000€ në të cilin dënim llogaritet edhe koha e kaluar në masën e paraburgimit dhe masën e arrestit shtëpiak prej datës nga data 24.02.2021 deri me datë 24.05.2021 , i cili dënim nuk do të ekzekutohet deri sa aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Nëse dënimin me gjobë e pandehura A.U, nuk dëshirojnë ta paguajnë ose nuk mundën ta paguajnë gjykata bazuar në nenin 43 par 3 të KPRK-së, dënimin me gjobë mund t ia zëvendësojë në dënim me burgim.

Ne vështrim të nenit 59 par 2 nën par 2.3 të KPRK-së, të pandehurës i cakton;

DËNIMIN PLOTËSUES

Në mbështetje të nenit 62 par 3 të KPRK-së, të pandehurës A.U, t'i **NDALOHET** për dy (2) vite ushtrimi i funksionit në administratë publike apo funksioneve në shërbime publike pas mbajtjes së dënimit me burgim.

II.Të pandehurit V.H, i shqiptohet dënim me burg prej 9 muaj dhe dënim me gjobë në shumë prej 500€ në të cilin vendim llogaritet edhe koha e kaluar në masën e paraburgimit dhe masën e arrestit shtëpiak nga data 30.06.2021 deri me datë 30.03.2022, i cili dënim nuk do të ekzekutohet deri sa aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Nëse dënimin me gjobë i pandehuri V.H, nuk dëshirojnë ta paguajnë ose nuk mundën ta paguajnë gjykata bazuar në nenin 43 par 3 të KPRK-së, dënimin me gjobë mund t ia zëvendësojë në dënim me burgim.

Ne vështrim të nenit 59 par 2 nën par 2.3 të KPRK-së, të pandehurit i cakton;

DËNIMIN PLOTËSUES

Në mbështetje të nenit 62 par 3 të KPRK-së, të pandehurit V.H, t'i **NDALOHET** për dy (2) vite ushtrimi i funksionit në administratë publike apo funksioneve në shërbime publike pas mbajtjes së dënimit me burgim.

Obligohet se cili i pandehur veç e veç pandehurit i lartcekur që ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës, në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej njëqind **(100) €**, ndërsa shumën prej njëqind **(100) €**, për Fondin për Kompensimin të Viktimave të Krimit, të gjitha ti

paguaj në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

IV. I pandehuri G.A, konfom nenit 364 par 1 të KPPRK-së,

ËSHTË FAJTOR

Gjatë muajit nëntor të vitit 2020, në fshatin Begrac, komuna Viti, i pandehuri G.A në mënyrë të drejtpërdrejtë ushtron ndikim te i pandehuri V.H dhe A.U zyrtarë në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë me qëllim që t'i ndihmojnë përfitimin e subvencionit në emër të fermeres E.A, në atë mënyrë që fillimisht fermerja E.A kishte aplikuar për përfitim të subvencioneve për vitin 2020, të pandehurit A.U dhe V.H në cilësi të inspektorëve kishin shkuar për kontroll në teren në fshatin Begrac duke gjetur disa parregullsi, mirëpo më vonë e pandehura A.U dhe V.H i kontaktohen nga i pandehuri G.A dhe i kërkojnë ryshfet dhe për të mos ta hartuar raportin negativ i pandehuri G.A i jep shumë 450€ të pandehurës A.U.

- *Me këtë ka kryer veprën penale Ushtrim i ndikimit nga neni 424 par.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës*

Andaj gjykata me aplikimin e neneve 7,17, 38, 39,40, 42,43, 69, 79, 424 par 2 të KPRK-së dhe nenit 364, 449, 450 dhe 452 të KPPRK-së, të pandehurin e :

G J Y K O N

Të pandehurin G.A, i shqiptohet dënim me burg prej 9 muaj dhe dënim me gjobë në shumë prej 100€, në të cilin vendim llogaritet edhe koha e kaluar në masën e arrestit shtëpiak prej datës nga data 30.06.2021 deri me datë 30.03.2022, i cili dënim nuk do të ekzekutohet deri sa aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Nëse dënimin me gjobë i pandehuri G.A, nuk dëshirojnë ta paguajnë ose nuk mundën ta paguajnë gjykata bazuar në nenin 43 par 3 të KPRK-së, dënimin me gjobë mund t ia zëvendësojë në dënim me burgim.

Obligohet i pandehuri i lartcekur që ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës, në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej njëqind **(100) €**, ndërsa shumën prej njëqind **(100) €**, për Fondin për Kompensimin të Viktimave të Krimin, të gjitha ti paguaj në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

V. I pandehuri F.Y, konfom nenit 364 par 1 të KPP-së,

ËSHTË FAJTOR

Gjatë muajit nëntor 2020, në Gjilan, i pandehuri F.Y, me qëllim të përfitimit të subvencioneve i jep para ryshfet të pandehurve A.U dhe B.P Inspektor në Rajonin e Gjilanit në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, në atë mënyrë që fillimisht i pandehuri F.Y kishte aplikuar për përfitim

të subvencioneve për krerë të lopëve në bazë të aplikimit nr.0/134364, datë 30.07.2020 të pandehurit A.U dhe B.P në cilësi të inspektorëve kishin shkuar për kontroll në teren dhe fillimisht kishin paraqitur disa vërejtjeje sepse disa nga krerët e lopëve nuk i kishin pasur të vendosura matrikulat, pastaj kishin kërkuar para ryshfet në vlerë prej 2,000 € për të mos ta hartuar raportin negativ dhe për këtë ishte pajtuar i pandehuri F.Y dhe sipas marrëveshjes paraprake me të pandehurit A.U dhe B.P pas disa ditësh i pandehuri F.Y i dorëzon para ryshfet të pandehurës A.U në vlerë prej 1,600 € në zyrën e Regjionale të AZHB-së në Gjilan.

- ***Me këtë ka kryer veprën penale Dhënie Ryshfeti nga neni 422 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës***

Andaj gjykata me aplikimin e neneve 7,17, 38, 39,40, 42,43, 46, 47, 48,49, 69, 422 par 1 të KPRK-së dhe nenit 364, 449, 450 dhe 452 të KPPRK-së, të pandehurin e :

G J Y K O N

Të pandehurit F.Y., i shqiptohet burg prej 6 muaj dhe dënim me gjobë në shumë prej 1000€, i cili dënim me kusht nuk do të ekzekutohet nëse i pandehurit në afat prej 1 viti nuk kryen vepër tjetër penale.

Obligohet i pandehuri i lartcekur që ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës, në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej njëqind (100) €, ndërsa shumën prej njëqind (100) €, për Fondin për Kompensimin të Viktimave të Krimit, të gjitha ti paguaj në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

- VI.** I pandehuri A.T, konfom nenit 364 par 1 të KPP-së,

Ë S H T Ë F A J T O R

Me datë 05.11.2020, në fshatin Stanqiq, komuna Gjilan, i pandehuri A.T me qëllim të përfitimit të subvencioneve i jep ryshfet të pandehurve A.U dhe V.H zyrtar në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, në atë mënyrë që fillimisht i pandehuri A.T kishte aplikuar për përfitim të subvencioneve për blegtori në bazë të aplikimit nr.08/140789, datë 06.08.2020, të pandehurit A.U dhe V.H në cilësi të inspektorëve kishin shkuar për kontroll në teren dhe fillimisht kishin paraqitur disa vërejtjeje rreth aplikimit, pastaj kishin kërkuar para ryshfet për të mos ta hartuar raportin negativ dhe pasi i pandehuri A.T i'u jep para ryshfet A.U dhe V.H secilit nga 100 €, atëherë në fund hartojnë Raportin nr.006814, datë 05.11.2020.

- ***Me këtë ka kryer veprën penale Dhënie Ryshfeti nga neni 422 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës***

Andaj gjykata me aplikimin e neneve 7,17, 38, 39,40, 42,43,46, 47, 48,49, 69, 422 par 1 të KPRK-së dhe nenit 364, 449, 450 dhe 452 të KPPRK-së, të pandehurin e :

G J Y K O N

Të pandehurin A.T, i shqiptohet dënim me burg prej 6 muaj dhe dënim me gjobë në shumë prej 1000€, i cili dënim me kusht nuk do të ekzekutohet nëse i pandehurit në afat prej 1 viti nuk kryen vepër tjetër penale.

Obligohet i pandehuri i lartcekur që ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës, në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej njëqind (100) €, ndërsa shumën prej njëqind (100) €, për Fondin për Kompensimin të Viktimave të Krimit, të gjitha ti paguaj në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

VII. I pandehuri B.O , konfom nenit 364 par 1 të KPP-së,

ËSHTË FAJTOR

Me datë 16.11.2020, në Pozhoran, komuna Viti, i pandehuri B.O, me qëllim të përfitimit të subvencioneve i jep para ryshfet të pandehurve A.U dhe V.H, Inspektor në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, në atë mënyrë që fillimisht i pandehuri B.O kishte aplikuar për përfitim të subvencioneve në bazë të aplikimit nr.30/152111, datë 24.08.2020, e pandehura A.U dhe V.H në cilësi të inspektorëve me datë 16.11.2020 kishin shkuar për kontroll në teren dhe fillimisht kishin paraqitur disa vërejtje rreth aplikimit, pastaj kishin kërkuar para ryshfet për të mos ta hartuar raportin negativ dhe i pandehuri B.O i'u jep ryshfet të pandehurve secilit nga 100 €, në oborrin e shtëpisë së tij, pastaj të pandehurit A.U dhe V.H hartojnë Raportin nr.002488 datë 16.11.2020.

- ***Me këtë ka kryer veprën penale Dhënie Ryshfeti nga neni 422 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.***

Andaj gjykata me aplikimin e neneve 7,17, 38, 39,40, 42,43,46, 47, 48,49, 69, 422 par 1 të KPRK-së dhe nenit 364, 449, 450 dhe 452 të KPPRK-së, të pandehurin e :

G J Y K O N

Të pandehurin B.O, i shqiptohet dënim me burg prej 6 muaj dhe dënim me gjobë në shumë prej 1000€, i cili dënim me kusht nuk do të ekzekutohet nëse i pandehurit në afat prej 1 viti nuk kryen vepër tjetër penale.

Obligohet i pandehuri i lartcekur që ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës, në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej njëqind (100) €, ndërsa shumën prej njëqind (100) €, për Fondin për Kompensimin të Viktimave të Krimit, të gjitha ti paguaj në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

VIII. I pandehuri A.S, konfom nenit 364 par 1 të KPP-së,

ËSHTË FAJTOR

Gjatë muajit nëntor të vitit 2020, në fshatin Uglar, komuna Gjilan, i pandehuri A.S, me qëllim të përfitimit të subvencioneve iu jep para ryshfet të pandehurve A.U dhe B.P Inspektor në Rajonin e Gjilanit në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, në atë mënyrë që fillimisht i pandehuri A.S kishte aplikuar për përfitim të subvencioneve në bazë të aplikimit nr.08/148753, datë 17.08.2020, të pandehurit A.U dhe B.P në cilësi të inspektorëve me datë 28.10.2020 kishin shkuar për kontroll në teren dhe fillimisht kishin paraqitur disa vërejtje, pastaj pas kontrollit takohen me të pandehurin A.S në parkingun e Restorantit “...” në hyrje të Gjilanit dhe gjatë bisedës i kërkojnë të pandehurit A.S para ryshfet në vlerë 2,000 € për të mos ta hartuar raportin negativ, atëherë në fund pajtohen për vlerën e ryshfetit 1,200 € dhe të pandehurit A.U dhe B.P hartojnë Raportin nr.006810, datë 28.10.2020, pastaj pasi i pandehuri A.S pranon parat e subvencioneve i dorëzon ryshfet të pandehurës A.U në vlerë prej 1,200 € në parkingun e Drejtorisë Regjionale për Bujqësi në Gjilan, ashtu siç ishte pajtuar paraprakisht edhe me të pandehurin B.P në parkingun e restorantit “...”.

- ***Me këtë ka kryer veprën penale Dhënie Ryshfeti nga neni 422 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës***

Andaj gjykata me aplikimin e neneve 7,17, 38, 39,40, 42,43,46, 47, 48,49, 69, 422 par 1 të KPRK-së dhe nenit 364, 449, 450 dhe 452 të KPPRK-së, të pandehurin e :

G J Y K O N

Të pandehurin A.S, i shqiptohet dënim me burg prej 6 muaj dhe dënim me gjobë në shumë prej 1000€, i cili dënim me kusht nuk do të ekzekutohet nëse i pandehurit në afat prej 1 viti nuk kryen vepër tjetër penale.

Obligohet i pandehuri i lartcekur që ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës, në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej njëqind (100) €, ndërsa shumën prej njëqind (100) €, për Fondin për Kompensimin të Viktimave të Krimit, të gjitha ti paguaj në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

- IX.** I pandehuri M.M, konfom nenit 364 par 1 të KPP-së,

ËSHTË FAJTOR

Gjatë muajit nëntor 2020, në fshatin Cërnicë, komuna Gjilan, i pandehuri M.M me qëllim të përfitimit të subvencioneve iu jep para ryshfet të pandehurës A.U dhe B.P zyrtar në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, në atë mënyrë që fillimisht M.M kishte aplikuar në emër të djalit të tij F.M “...” për përfitim të subvencioneve, i pandehuri B.P dhe A.U në cilësi të inspektorëve kishin shkuar për kontroll dhe fillimisht kishin paraqitur disa vërejtjeje, pastaj kishin kërkuar para ryshfet për të mos ta hartuar raportin negativ dhe për këtë ishte pajtuar i pandehuri M.M

duke iu dhënë A.U dhe B.P secilit nga 100 € në oborrin e fermës, pastaj në rastin tjetër derisa i pandehuri M.M kishte aplikuar për përfitimin e grantit në emër familjares N.M në emër të firmës "...", të nesërmen ishte kontaktuar A.U ku i kishte kërkuar ryshfet shumë 1,000 €, mirëpo i pandehuri M.M pajtohet dhe ia jep shumë 500 € te market "...” në Gjilan.

- ***Me këtë ka kryer veprën penale Dhënie Ryshfeti nga neni 422 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës***

Andaj gjykata me aplikimin e neneve 7,17, 38, 39, 40, 42, 43, 46, 47, 48, 49, 69, 422 par 1 të KPRK-së dhe nenit 364, 449, 450 dhe 452 të KPPRK-së, të pandehurin e :

G J Y K O N

Të pandehurin M.M, i shqiptohet dënim me burg prej 6 muaj dhe dënim me gjobë në shumë prej 1000€, i i cili dënim me kusht nuk do të ekzekutohet nëse i pandehurit në afat prej 1 viti nuk kryen vepër tjetër penale.

Obligohet i pandehuri i lartcekur që ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës, në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumë prej njëqind (100) €, ndërsa shumë prej njëqind (100) €, për Fondin për Kompensimin të Viktimave të Krimit, të gjitha ti paguaj në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

E dëmtuara Avokatura Shtetërore e Kosovës pranë Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Kosovës në Prishtinë, për realizimin e kërkesës pasurore – juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

A R S Y E T I M

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, ka ngritur aktakuzën PPS.nr.52/2024 të datë 21.03.2024, kundër të pandehurve K.Z për shkak të veprës penale Ushtrimi i ndikimit nga neni 424 par.1 i KPRK-së, i pandehuri B.S për shkak të veprës penale Ushtrimi i ndikimit nga neni 424 par.2 i KPRK-së dhe veprës penale Mashtrim me subvencione nga neni 324 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së, të pandehurit L.S dhe S.Sh për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Marrje ryshfeti nga neni 421 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, e pandehura K.S për shkak të veprës penale Dhënie ryshfeti nga neni 422 par.2 të KPRK-së, e pandehura A.Gj për shkak të veprës penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.1 të KPRK-së, të pandehurit L.S dhe S.Sh për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Marrje ryshfeti nga neni 421 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, të pandehurit A.U dhe V.H për shkak të veprës penale në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi kanë kryer veprën penale Marrje ryshfeti nga neni 421 par.1 lidhur me nenin 31 dhe nenin 77 të KPRK-së, të pandehurit A.U dhe B.P për shkak se në vazhdimësi dhe në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Marrje ryshfeti nga neni 421 par.1 lidhur me nenin 31 dhe 77 të KPRK-së, i pandehuri G.A për shkak të veprës penale Ushtrim i ndikimit nga neni 424 par.2 të KPRK-së, e pandehura V.I për shkak të veprës penale Dhënie e ryshfetit nga neni 422 par.1 të KPRK-së, i pandehuri F.J për shkak të veprës penale Dhënie e ryshfetit nga neni 422 par.1 të KPRK-së, i pandehuri F.Y për shkak të veprës penale Dhënie e ryshfetit nga neni 422 par.1 të KPRK-së, i pandehuri A.T për shkak të veprës penale

Dhënie e ryshfetit nga neni 422 par.1 të KPRK-së, i pandehuri B.O për shkak të veprës penale
Dhënie e ryshfetit nga neni 422 par.1 të KPRK-së, i pandehuri A.S për shkak të veprës penale
Dhënie e ryshfetit nga neni 422 par.1 të KPRK-së, i pandehuri M.M për shkak të veprës penale
Dhënie e ryshfetit nga neni 422 par.1 të KPRK-së, i pandehuri A.N për shkak të veprës penale
Mashtrimi me subvencione nga neni 324 par.1 të KPRK-së, e që aktakuzës ia ka bashkangjitur
edhe marrëveshjet e pranimit të fajësisë PPS.nr.88/21 e datës 08.03.2024 për të pandehurin
V.H, marrëveshjen për pranimin e fajësisë PPS.nr.88/21 e datës 13.12.2021 për të pandehurin
G.A, marrëveshjen për pranimin e fajësisë PPS.nr.88/21 e datës 13.03.2024 për të pandehurën
K.B-S, marrëveshjen për pranimin e fajësisë PPS.nr.88/21 e datës 07.12.2023 për të
pandehurin F.Y, marrëveshjen për pranimin e fajësisë PPS.nr.88/21 e datës 07.12.2023 për të
pandehurin A.T, marrëveshjen për pranimin e fajësisë PPS.nr.88/21 e datës 08.12.2023 për të
pandehurin B.O, marrëveshjen për pranimin e fajësisë PPS.nr.88/21 e datës 08.12.2023 për të
pandehurin M.M, marrëveshjen për pranimin e fajësisë PPS.nr.88/21 e datës 08.12.2023 për
të pandehurin A.S dhe marrëveshjen për pranimin e fajësisë PPS.nr.88/21 e datës 13.03.2024
për të pandehurin B.S.

Gjykata, në kuptim të nenit 241 par.3 të KPPRK-së, në seancën e shqyrtimit fillestar i mbajtur
me datë 08.05.2024, i ka udhëzuar të akuzuarit për të drejtat e tyre ligjore dhe pas leximit të
aktakuzës nga ana e Prokurorit Special, dhe në pika përmbledhëse elaboroi marrëveshje për
pranimin e fajësisë PPS.nr.88/21 e datës 08.03.2024 për të pandehurin V.H, marrëveshjen për
pranimin e fajësisë PPS.nr.88/21 e datës 13.12.2021 për të pandehurin G.A, marrëveshjen për
pranimin e fajësisë PPS.nr.88/21 e datës 13.03.2024 për të pandehurën K.B-S, marrëveshjen
për pranimin e fajësisë PPS.nr.88/21 e datës 07.12.2023 për të pandehurin F.Y, marrëveshjen
për pranimin e fajësisë PPS.nr.88/21 e datës 07.12.2023 për të pandehurin A.T, marrëveshjen
për pranimin e fajësisë PPS.nr.88/21 e datës 08.12.2023 për të pandehurin B.O, marrëveshjen
për pranimin e fajësisë PPS.nr.88/21 e datës 08.12.2023 për të pandehurin M.M,
marrëveshjen për pranimin e fajësisë PPS.nr.88/21 e datës 08.12.2023 për të pandehurin A.S
dhe marrëveshjen për pranimin e fajësisë PPS.nr.88/21 e datës 13.03.2024 për të pandehurin
B.S, duke deklaruar se cili veç e veç se mbeten në tërësi pranë marrëveshjes për pranimin e
fajësisë, se të pandehurit e lartcekur dhe mbrojtësit e tyre janë pajtuar për të gjitha pikat e
aktakuzës, për dënimin e rekomanduar, se të pandehurit e lartcekur me vullnet të plotë, me
vetëdije të plotë dhe pa kurrfarë trysnie se cili veç e veç e ka pranuar fajësinë e duke qenë të
vetëdijshëm për pasojat dhe benefitet për pranimin e fajësisë, të cilin pranim e kanë bërë pas
konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësit e tyre dhe kërkojnë nga gjykata që pasi që ti
vlerësoi të njëjtat marrëveshjet të aprovohen. Andaj gjykata i ka udhëzuar të njëjtit në
vështrimin të nenit 242, mbi të drejtën e deklarimit ose jo të pranimit të fajësisë. Të pandehurit
V.H, G.A, K.B-S, F.Y, A.T, B.O, M.M, A.S dhe B.S, se cili veç e veç deklaroi se mbetem në
tersi pranë marrëveshjes së arritur në prokurori dhe e pranojnë fajësinë për veprat penale për
të cilat akuzohen, ndërsa e pandehura A.U, deklaroi se e pranojmë fajësinë se në
bashkëkryerje dhe në vazhdimësi ka kryer veprën penale Marrje Ryshfeti nga neni 421
paragrafi 1 lidhur me nenin 31 dhe nenin 77 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, ndërsa
të pandehurit K.Z, L.S, S.S, B.P, A.Gj, A.N, V.I, dhe F.J, nuk e pranuan fajësinë për veprat
penale për të cilat akuzohen.

Sipas Aktvendimit të Gjykatës Themelor në Prishtinë-Departamentit Special, PS.nr.30/2024, me
datë 08.05.2024, pas marrjes së propozimeve dhe mendimit të palëve në procedurë, konform
nenit 35 par. 1 dhe par. 2 veçohet procedura penale ndaj të pandehurve V.H, G.A, K.B-S, F.Y,
A.T, B.O, M.M, A.S, B.S dhe A.U, për arsyeje të efikasitetit të procedurës të kësaj çështje
penale.

I pandehuri B.S në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi se kam kuptuar dispozitivin e aktakuzës dhe nuk kam nevojë për sqarime shtesë, po ashtu e pranoj marrëveshjen e lidhur mbi pranimin e fajësisë PPS.nr.88/2021 e datës 13.03.2024 dhe qëndroj në tërësi pranë kësaj marrëveshje.

Mbrojtësi i të pandehurit B.S, Av.Florin Vërtopi në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi se në bazë të nenit 230 par.17 të KPPRK-së gjykatës i propozoj që t'a bëjë pranimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe të urdhëroi që kjo marrëveshje të vendoset në shkresë të lëndës siç e përcakton neni 230 par.20 i KPPRK-së, duke dhënë arsyetimin detajisht të përcaktuar si vijon: "I pandehuri respektivisht i mbrojturi im e ka kuptuar në tërësi natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajësisë për dy veprat penale mbështetet edhe në prova materiale të cilat PSRK-ja i ka paraqitur prej fq.34-37 të aktakuzës dhe po ashtu nuk ekziston asnjë rrethanë tjetër nga neni 248 që mund të përjashtoj pranimin e fajësisë, kështu që i propozojmë gjykatës që ta bëjë pranimin e kësaj marrëveshje dhe pasi që ta bëjë këtë pranim me rastin e shqiptimit të dënimit pa pas nevojë të caktohet seancë për caktimin e dënimit, gjykata të marrë parasysh se marrëveshja për pranimin e fajësisë të detalizon edhe pjesën e marrëveshjes nga neni 231 par.9.6 e që ka të bëjë me dënimin nën kufijtë e përcaktuar me ligj, po ashtu i mbrojturi im në tërësi e ka përmbushë dëmin ndaj buxhetit të RKS e kjo është saktësuar edhe në marrëveshjen për pranimin e fajësisë që B.S e ka bërë kthimin prej 184,857.53 euro andaj me të drejtë prokurori edhe ka propozuar që kjo shumë të konfiskohet, ndërsa nuk udhëhiqet në asnjë procedurë tjetër penale ndaj tij, është i padënuar, është baba i dy fëmijëve, është lënduar thellë dhe ka shpreh keqardhje të jashtëzakonshme për dëmin që ka shkaktuar, dhe në fund i mbrojturi im ka luajtur rol shumë të vogël aktiv, siç është përshkruar në dispozitivin e aktakuzës. Si fund, besojmë që gjykata do të akceptoj propozimin e PSRK-së.

E pandehura K.B-S në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi se e kam kuptuar dispozitivin e aktakuzës dhe nuk kam nevojë për sqarime shtesë, po ashtu e pranoj marrëveshjen e lidhur mbi pranimin e fajësisë PPS.nr.88/2021 e datës 13.03.2024 dhe qëndroj në tërësi pranë kësaj marrëveshje.

Mbrojtësi i të akuzuarës K.B-S, Av.Ali Rexha në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi se klientja ime në bashkëpunim me mua kemi shkuar në prokurorinë speciale dhe kemi arritur marrëveshje për pranim të fajësisë dhe kërkojmë nga gjykata që e njëjta të aprovohet ashtu siç jemi marrë vesh në marrëveshje.

E pandehura A.U në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi se e kam kuptuar dispozitivin e aktakuzës dhe nuk kam nevojë për sqarime shtesë, dhe e pranon fajësinë se në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi kanë kryer veprën penale Marrje Ryshfeti nga neni 421 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 dhe nenin 77 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Mbrojtësi i të akuzuarës A.U, Av.Rafet Ferizi në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi se e mbrojtura ime është e vetëdijshme për pranimin e fajësisë duke i ofruar edhe bashkëpunim prokurorisë lidhur me këtë çështje, po ashtu kërkoj nga gjykata që pranimin e fajësisë gjatë shqiptimit të dënimit ta përdor si rrethanë lehtësuese konform KPPRK-së.

I pandehuri V.H në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi se e kam kuptuar dispozitivin e aktakuzës dhe nuk kam nevojë për sqarime shtesë, po ashtu e pranoj marrëveshjen e lidhur mbi pranimin e fajësisë PPS.nr.88/2021 e datës 08.03.2024 dhe qëndroj në tërësi pranë kësaj marrëveshje.

Mbrojtësi i të akuzuarit V.H, Av.Amir Bunjaku në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi se meqenëse është arritur marrëveshja për pranimin e fajësisë me PSRK-në atëherë propozojmë gjykatës që të aprovoj këtë marrëveshje e cila është arrit konform KPPRK-së si dhe pas konsultimit të plotë me klientin tim.

I pandehuri G.A në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi se e kam kuptuar dispozitivin e aktakuzës dhe nuk kam nevojë për sqarime shtesë, po ashtu e pranoj marrëveshjen e lidhur mbi pranimin e fajësisë PPS.nr.88/2021 e datës 13.12.2021 dhe qëndroj në tërësi pranë kësaj marrëveshje.

Mbrojtësi i të akuzuarit G.A, Av.Mehdi Kozhani në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi se bazuar në marrëveshjen për pranim të fajësisë të lidhur me PSRK-në kërkohet nga gjykata të aprovohet kjo marrëveshje dhe të shqiptohet dënimi sipas kësaj marrëveshje mirëpo kërkohet që procedura të veçohet meqenëse i njëjti ka probleme shëndetësore dhe i njëjti duhet të merr trajtim jashtë vendit.

I pandehuri F.Y në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi se e kam kuptuar dispozitivin e aktakuzës dhe nuk kam nevojë për sqarime shtesë, po ashtu e pranoj marrëveshjen e lidhur mbi pranimin e fajësisë PPS.nr.88/2021 e datës 07.12.2023 dhe qëndroj në tërësi pranë kësaj marrëveshje.

Mbrojtësi i të akuzuarit F.Y, Av.Arbër Jupolli në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi se e mbështes deklarin e të mbrojturit tim për pranimin e fajësisë, po ashtu e formalizuar me marrëveshjen për pranim të fajësisë e përpiluar me datë 07.12.2023, e po ashtu edhe rekomandimin për sanksionin penal të propozuar nga ana e prokurorit special. E njoftoj gjykatën se kjo marrëveshje për pranimin e fajësisë nuk bie ndesh me asnjërën nga pikat e përkrahura në par.17 pikat 17.1, 17.2, 17.3 dhe 17.4 të nenit 230 të KPPRK-së ashtu që i mbrojturi im e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranim të fajësisë këtë pranim e ka bërë vullnetarisht dhe në konsultim me mua si mbrojtës i tij, pranimi i fajësisë nga i mbrojturi im mbështetet në prova të bashkëngjitura në aktakuzë dhe nuk ekzistojnë rrethanat e parapara në nenin 248 të KPPRK-së që do ta bënin të pavlefshme këtë marrëveshje. I mbrojturi im nuk është i dënuar më parë në asnjë aktgjykim të formës së prerë, është person familjar, baba i 4 fëmijëve prandaj edhe rekomandimi i dënimit është në përputhje të plotë dhe propozoj që i njëjti të pranohet.

I pandehuri A.T në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi se e kam kuptuar dispozitivin e aktakuzës dhe nuk kam nevojë për sqarime shtesë, po ashtu e pranoj marrëveshjen e lidhur mbi pranimin e fajësisë PPS.nr.88/2021 e datës 07.12.2023 dhe qëndroj në tërësi pranë kësaj marrëveshje.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.T, Av.Besnik Beqiri në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi se i propozojmë gjykatës të bëjë aprovimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, e po ashtu të shqiptoj edhe dënimin e rekomanduar në këtë marrëveshje pasi që siç tha edhe i mbrojturi im se këtë marrëveshje e ka nënshkruar pasi ka kuptuar benefitet dhe pasojat e pranim të fajësisë, kjo marrëveshje është bërë konform dispozitave të KPPRK-së e po ashtu edhe dënimi i rekomanduar është brenda kufijve ligjor andaj edhe kërkohet që e njëjta të aprovohet.

I pandehuri B.O në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi se e kam kuptuar dispozitivin e aktakuzës dhe nuk kam nevojë për sqarime shtesë, po ashtu e pranoj marrëveshjen e lidhur mbi pranimin e fajësisë PPS.nr.88/2021 e datës 08.12.2023 dhe qëndroj në tërësi pranë kësaj

marrëveshje, si dhe deklaroi se e kuptoj natyrën e veprës penale dhe i pranoi veprimet e mia dhe qëndroj në tërësi pranë marrëveshjes.

Mbrojtësi i të akuzuarit B.O, Av.Basri Morina në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi se i propozoj gjykatës të aprovoj pranimin e fajësisë konform dispozitave të nenit 241 të KPPRK-së. I mbrojturi im e ka pranuar dhe kuptuar pranimin e fajësisë e këtë e ka bërë edhe para prokurorit special. I propozoj gjykatës të bëjë pranimin e marrëveshjes dhe me rastin e shqyrtimit të dënimit gjykata të merr parasysh pranimin e fajësisë. I mbrojturi im kurrë nuk ka rënë ndesh më ligjin, është njeri familjar, prind i 4 fëmijëve madje nuk ka pas asnjë kundërvajtje. Është penduar sinqerisht për këtë që ka ndodhur, ka shpreh keqardhje, ka qenë i frikësuar se do të vendoset në listën e zezë dhe për 5 vite të ardhshme nuk ka benefite.

I pandehuri A.S në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi se e kam kuptuar dispozitivin e aktakuzës dhe nuk kam nevojë për sqarime shtesë, po ashtu e pranoi marrëveshjen e lidhur mbi pranimin e fajësisë PPS.nr.88/2021 e datës 08.12.2023 dhe qëndroj në tërësi pranë kësaj marrëveshje.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.S, Av.Besim Curri në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi se marrë parasysh se i mbrojturi im është njoftuar për pasojat dhe benefitet e pranimit të fajësisë duke qenë se ai asnjëherë më parë nuk ka qenë i dënuar ose subjekt i dyshuar për ndonjë keqpërdorim, ne i propozojmë gjykatës që të aprovoj marrëveshjen e arritur duke fuqizuar edhe masat e dakorduara pasi të njëjtat janë edhe konform dispozitave të ligjit dhe nuk bien ndesh me asnjë dispozitë ligjore të cilat ndërliken me marrëveshjen.

I pandehuri M.M në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi se e kam kuptuar dispozitivin e aktakuzës dhe nuk kam nevojë për sqarime shtesë, po ashtu e pranoi marrëveshjen e lidhur mbi pranimin e fajësisë PPS.nr.88/2021 e datës 08.12.2023 dhe qëndroj në tërësi pranë kësaj marrëveshje.

Mbrojtësi i të akuzuarit M.M, Av.Betim Shala në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi se bazuar në faktin se i pandehuri ka pranuar fajësinë në fazat fillestare në prokurori dhe pas analizimit të provave ka ardhur edhe deri tek lidhja e kësaj marrëveshje kështu që qëndrojmë pranë kësaj marrëveshje dhe i propozojmë gjykatës që të njëjtën ta aprovoj.

Prokurori i Prokurorisë Speciale në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi se lidhur me marrëveshjet për pranimin e fajësisë dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve V.H, G.A, K.B-S, F.Y, A.T, B.O, M.M, A.S dhe B.S, siç duket deri më tani në bazë të evidencës për pranim të fajësisë nga të pandehurve të lartcekur dhe e pandehura A.U sot bëri pranimin e fajësisë në shqyrtim fillestar, ndërsa sa i përket pranimit të fajësisë për të gjithë të pandehurit që kanë arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë e njoftoj gjykatën se marrëveshjet janë përpiluar dhe lidhur në përputhje të plotë me dispozitat e KPPRK, dhe marrëveshjet janë arritur me të pandehurit vullnetarisht në prani të mbrojtësve, dhe me të gjithë të pandehurit pranimi i fajësisë është shqyrtuar dhe analizuar se është në përputhje të plotë edhe me prova tjera materiale që janë paraqitur në aktakuzë, të gjithë të pandehurit të cilët kanë lidhur marrëveshje për pranim të fajësisë, pranimin e fajësisë e kanë bërë që në fazën fillestare të marrjes në pyetje në prokurori dhe pranimi i tyre ka ndihmuar edhe në ndriçimin e rasteve tjera dhe ka qenë edhe në interes të drejtësisë ku në disa raste edhe vet shkaktimi i dëmit që është bërë nga të pandehurit është kthyer në buxhetin e RKS. ku vlen të përmendet se i pandehuri B.S që nga dita e parë ka premtuar se do ta kthejë dëmin e shkaktuar dhe i njëjti brenda 1 viti ka kthyer rreth 184.000 euro të cilat sipas procedurës janë sekuestruar dhe tashmë konsiderohen përmbushje e dëmit të shkaktuar. Duke

marrë për bazë të gjitha marrëveshjet e paraqitura i propozoj gjykatës që ti pranoj këto marrëveshje dhe të njëjtat të vendosen në shkresa të lëndës. Po ashtu, sa i përket të pandehurës A.U e cila është akuzuar për Marrje ryshfeti në vazhdimësi që në fazën fillestare ka pranuar fajësinë për marrje të ryshfetit dhe ka qenë bashkëpunuese me prokurorinë dhe ka kontribuar në interes të drejtësisë. Po ashtu e njëjta gëzon edhe statusin e veçantë dhe kërkojmë nga gjykata të ketë parasysh të gjitha këto rrethana me rastin e shqiptimit të dënimit për të pandehurën.

Gjykata gjatë shqyrtimit të pranimit apo mospranimit të marrëveshjeve për pranimin e fajësisë, pas dëgjimit të prokurorit special, të pandehurve V.H, G.A, K.B-S, F.Y, A.T, B.O, M.M, A.S dhe B.S, dhe mbrojtësit të tyre, komfor nenit 230 par 17 të KPPRK-së, përcaktoi se të pandehurit V.H, G.A, K.B-S, F.Y, A.T, B.O, M.M, A.S dhe B.S, në tërësi e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga të pandehurit e lartcekur, pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësit e tyre dhe se nuk ka qenë të detyruar ose shtrënguar në asnjë mënyrë që ta pranojë fajësinë, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat materiale të rastit konkret, të cilat paraqiten në aktakuzë dhe nuk ekziston asnjë nga rrethanat e paraqitura në nenin 248 par. 1 të këtij Kodi.

Gjykata pas marrjes së mendimit të prokurorit special, mbrojtësve dhe të pandehurve V.H, G.A, K.B-S, F.Y, A.T, B.O, M.M, A.S dhe B.S, dhe pasi që është bindur se janë përmbushur të gjitha kushtet e parapara nga neni 230 par 17 të KPPRK-së, komfor nenit 230 par 20 të KPPRK-së, me Aktvendim pranoi Marrëveshjet për pranimin e fajësisë PPS.nr.88/21 e datës 08.03.2024 për të pandehurin V.H, marrëveshjen për pranimin e fajësisë PPS.nr.88/21 e datës 13.12.2021 për të pandehurin G.A, marrëveshjen për pranimin e fajësisë PPS.nr.88/21 e datës 13.03.2024 për të pandehurën K.B-S, marrëveshjen për pranimin e fajësisë PPS.nr.88/21 e datës 07.12.2023 për të pandehurin F.Y, marrëveshjen për pranimin e fajësisë PPS.nr.88/21 e datës 07.12.2023 për të pandehurin A.T, marrëveshjen për pranimin e fajësisë PPS.nr.88/21 e datës 08.12.2023 për të pandehurin B.O, marrëveshjen për pranimin e fajësisë PPS.nr.88/21 e datës 08.12.2023 për të pandehurin M.M, marrëveshjen për pranimin e fajësisë PPS.nr.88/21 e datës 08.12.2023 për të pandehurin A.S dhe marrëveshjen për pranimin e fajësisë PPS.nr.88/21 e datës 13.03.2024 për të pandehurin B.S, të lidhur ndërmjet Kryeprokurorit të PSRK dhe Prokurorit Special në një të njëjtën anë si dhe të pandehurve të lartcekur dhe mbrojtësit në anën tjetër dhe urdhëroi që Marrëveshjet e lartcekura të vendosen në shkresat e lëndës së kësaj gjykate, e që palët në procedurë janë pajtuar me pranimin e marrëveshjes se pranuar nga gjykata pa asnjë vërejtje.

Me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit për të pandehurit V.H, G.A, K.B-S, F.Y, A.T, B.O, M.M, A.S dhe B.S, e të rekomanduar në Marrëveshjet e pranuar nga gjykata, e njëjta mori parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit në pajtim me nenin 69 të KPRK-së, ku si rrethana lehtësuese mori sjelljen e tyre korrekte në gjykatë gjatë shqyrtimit fillestar, pranimin e fajësisë, pendimin e thellë për veprat e kryera penale, sinqeritetin e tyre deklarues, e të gjitha këto të përfshira në marrëveshjet për pranimin e fajësisë, në të cilën janë dakorduar për vendimin mbi dënimin dhe lartësinë e tij, e duke pasur parasysh se gjykata i pranoi Marrëveshjet për pranimin e fajësisë, andaj edhe të pandehurve V.H,G.A, K.B-S, F.Y, A.T, B.O, M.M, A.S dhe B.S, ju shqiptoi dënimin si në dispozitiva e këtij aktgjykimi, e në pajtim me nenin 38 të KPRK-së, duke qenë e bindur se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit si në dispozitiva e këtij aktgjykimi.

Gjykata, gjendjen faktike në raport me veprat penale të përshkruara në aktin akuzues dhe në dispozitivin e këtij aktgjykimi, i ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga e pandehura A.U, ku

për shkak të pranimit të fajësisë, gjykata fare nuk i ka administruar provat e çështjes. Sipas detyrës zyrtare dhe konform nenit 251 të KPPRK, gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa-pranueshme, gjithashtu në tërësi ka vërtetuar se e pandehura A.U, i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë për veprat penale për të cilat akuzohet, pranimin e fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe në konsultë të plotë me mbrojtësit e saj, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat materiale të cilat janë parashtruar me aktin akuzues e për të cilat e pandehura A.U, kanë qenë e njoftuar me kohë me të gjitha provat materiale dhe të njëjtat nuk i kanë kundërshtuar, por ka pranuar fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohen. Gjykata, erdhi në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurës të lartcekur është bërë në pajtim me nenin 242 të KPPRK, dhe të njëjtin edhe e ka aprovuar në pajtim me faktet e provat që përmban akti akuzues, ku në veprimet e pandehurës A.U, formohen të gjitha elementet se në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi ka kryer veprën penale Marrje Ryshfeti nga neni 421 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 dhe nenin 77 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, për këtë gjykata të pandehurën e lartcekur i shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimet sikurse në dispozitiva të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerëson se nuk qëndron pretendimi i PSRK se, se e pandehura A.U në pikën 8. dhe në pikën 9 . të aktakuzë, të akuzohet dy herë për veprat penale me kualifikimin të njëjtë juridik se në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi ka kryer veprën penale Marrje Ryshfeti nga neni 421 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 dhe nenin 77 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, andaj gjykata ri cilëson në favor të pandehurës se në veprimet e të pandehurës A.U manifestohet të gjitha elemente se në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi ka kryer veprën penale Marrje Ryshfeti nga neni 421 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 dhe nenin 77 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, të përshkruara si në dispozitivin **III.** të këtij aktgjykimi.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin, respektivisht shqiptimit të dënimit me burgim dhe me gjobë, gjykata në harmonim 69, 70 të KPRK, vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat kanë ndikimin në përcaktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, e ku si rrethana lehtësuese vendimtare të cilat kanë ndikuar në përcaktimi e dënimit janë: pranimi i fajësisë nga e pandehurës A.U, ëpër veprat penale për të cilat akuzohet, bashkëpunimi dhe sjellja e saj korrekte me prokurorin dhe me gjykatën, por gjithashtu edhe me organet e ndjekjes penale dhe atë që në fazat e hershme hetimore, ku një fakt të tillë e dëshmon edhe vet përfaqësuesi i organit të akuzës, ndërsa si rrethana rëndues gjykata mori; veprimet e vazhdueshme të kundërligjshme të pandehurës A.U, vendosmëria e saj në vazhdimësi për kryerjen e veprën penale Marrje Ryshfeti, për të cilën veprën penale ka qenë në njohuri se është e ndaluar me ligj, duke marrë parasysh përgatitjen e saj shkollore, por e njëjta me shkallën e lartë të dashjes ka vepruar kundërligjshme në mënyrë të vazhdueshme për përshkruar si në pikat e dispozitivit **III.** të këtij aktgjykimit, andaj duke u bazuar në të gjitha këto që u elaboruan, gjykata të pandehurës së lartcekur i shqiptoi sanksionin penal sikurse në dispozitiv **III.** të këtij aktgjykimi, duke konsideruar se i përgjigjen shkallës së përgjegjësisë penalo juridike të saj dhe se me këtë sanksion dhe detyrim do të arrihet qëllimi preventiv i dënimit, që në të ardhmen të pandehura e lartcekur të përmbahen nga veprimet e tilla dhe se të integrohen në shoqëri.

Në rastin konkret gjykata vlerësoi se dënimet e shqiptuar si në dispozitiva të këtij aktgjykimi janë në proporcion me peshën e veprave penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesve sipas nenit 69 të KPPRK-së, shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesve, me bindje se dënimi i tillë do të ndikojë në risocializimin dhe riedukimin e kryesve, si dhe do të ndikojë te të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i përgjithshëm i dënimit.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale (paushallin gjyqësor), është marrë komfor neneve 449, 450 dhe 452 të KPPRK, pasi që gjykata në këtë çështje penale ka marrë aktgjykim dënues.

Vendimi mbi kompensimin e viktimave të krimit, gjykata e mori komfor nenit 36 par.3 nënpar.3.3 të Ligjit për Kompensimin e viktimave të krimit (Ligji Nr.08/L-109).

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në bazë të nenit 364 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiva të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI SPECIAL
PS.nr.30/2024, datë 13.05. 2024**

Zyrtar ligjor,
Ardita Mustafa

Kryetarja e trupit gjykues – Gjyqtarja
Violeta Namani-Hajra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 30 ditëve nga dita e marrjes së të njëjtit, e përmes kësaj gjykate.